



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 30

2002

Qershor

### P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 8909, datë 6.6.2002	Për ratifikimin e Konventës nr. 177 “Puna në shtëpi, 1996” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës..... 931
Ligj nr.8910, datë 6.6.2002	Për ratifikimin e Konventës nr.150 “Administrimi i punës, 1978” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës..... 935
Ligj nr. 8911, datë 6.6.2002	Për ratifikimin e Konventës nr.178 “Inspektimi i punës (detarët), 1996” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës..... 940
Vendim i KM nr. 272, datë 20.6.2002	Për një shtesë në vendimin nr. 418, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të falimentuara në rrugë administrative”..... 945
Vendim i KM nr. 273, datë 20.6.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 186, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave “Për karakteristikat metrologjike të mjeteve matëse”..... 945

Vendimi i KM nr. 274, datë 20.6.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 225, datë 19.5.1993 të Këshillit të Ministrave “Për tarifatat e regjistrimit dhe pagesat e verifikimit e të kalibrit fillestar ose periodik të mjeteve matëse”, ndryshuar me vendimet nr. 268, datë 19.6.1997, dhe nr. 255, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave.....	946
Vendimi i KM nr. 278, datë 20.6.2002	Për një ndryshim në rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së zbatimit të kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë” .....	948
Udhëzim datë 27.6.2002	Për “Mënyrën e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave dhe dokumentacionit të shoqërive që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” .....	949
	<i>Vendim (i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lutfi Jakup Mara.....	950

**LIGJ**  
**Nr. 8909, datë 6.6.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.177 “PUNA NË SHTËPI, 1996” TË  
ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.177 “Puna në shtëpi, 1996” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3375, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.**

**LIGJ**  
**Nr. 8910, datë 6.6.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.150 “ADMINISTRIMI I PUNËS, 1978” TË  
ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.150 “Administrimi i Punës, 1978” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3376, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.**

**LIGJ**  
**Nr. 8911, datë 6.6.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.178 “INSPEKTIMI I PUNËS (DETARËT), 1996”  
TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.178 “Inspektimi i Punës (Detarët), 1996” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3377, datë 24.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.**

**VENDIM**  
**Nr. 272, datë 20.6.2002**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.418, DATË 9.7.1998, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË  
FALIMENTUARA NË RRUGË ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48/1. të ligjit nr.8071, datë 25.10.1995, “Për procedurat e falimentimit”, të ndryshuar me dekretin nr.1561, datë 25.7.1996, të miratuar në ligjin nr.8140, datë 5.9.1996, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Kudo në vendimin nr.418, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për industrinë”.
2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 273, datë 20.6.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.186, DATË 16.4.1993, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KARAKTERISTIKAT METROLOGJIKE TË MJETEVE MATËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.7 datë 20.10.1992, “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe i Punës dhe çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.186, datë 16.4.1993, të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:  
Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:  
“7/1. Karakteristikat metrologjike të aparateve matëse taksimetra janë ato që jepen në tabelën 7, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.”.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

Mënyra e verifikimit	Gabimi maksimal i lejueshëm në $\pm$ %			
	Verifikimi fillestar		Verifikimi periodik	
	Sipas kohës	Sipas distancës	Sipas kohës	Sipas distancës
Verifikimi i aparatit matës taksimetër si njësi me vehte				
Verifikimi i aparatit matës taksimetër në sistemin taksimetër-taksi				
Verifikimi i kombinuar (njësi matëse-tarifë shërbimi) i aparatit matës taksimetër në sistemin taksimetër-taksi				

**VENDIM**  
**Nr. 274, datë 20.6.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.225, DATË 19.5.1993, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR TARIFAT E REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT E TË**  
**KALIBRIMIT FILLESTAR OSE PERIODIK TË MJETEVE MATËSE NDRYSHUAR ME**  
**VENDIMET NR.268, DATË 19.6.1997, DHE NR.255, DATË 20.4.2001, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992, “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

Në pasqyrën nr.2, që bashkëlidhet vendimit nr.225, datë 19.5.1993, të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhet ky ndryshim:

Pas pikës 1.3 shtohet pika 1.4 me këtë përmbajtje:  
“1.4. Aparatet matëse taksimetra 3 000 lekë.”.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko

#### ANALIZA E KOSTOS PËR VERIFIKIMIN E TAKSIMETRAVE

Përbërësit e analizës së Kostos	
- Koha e punës e nevojshme për verifikim	3 orë
- Koha për vajtje ardhje në subjekt	30 orë
- Koha për mbushje dokumentacioni	30 min
- Koha për verifikim praktik	
- kontrolli i përgjithshëm i makinës dhe taksimetrit	30 min
- verifikimi i pagesës në kohë	30 min
- verifikimi i pagës me rrugë	1 orë
1. Shpenzime për pagesën e inspektorit	
- 200 paga orare x 2 inspektorë x 3 orë	1200 lekë
2. Shpenzime amortizimi bazës etalonuese	
- amortizimi i etaloneve të përdorur -----	500 lekë
- shpenzime verifikimi bazës etalonuese -----	500 lekë
3. Shpenzime të automjetit -----	
- karburant 12 litrat x 90 lek/litri x 15km	200 lekë
- amortizimi orar automjetit	100 lekë
4. Shpenzime për bazë materiale dhe lëndë të parë	
	100 lekë
	Shuma=2600 lekë
5. Shpenzime administrative	
- 20% e shumës .....	520 lekë
- Çmimi real (shumë+ shpenzime administrative).....	3120 lekë
- Çmimi i pranuar.....	3000 lekë

#### VENDIM

Nr. 278, datë 20.6.2002

#### **PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave,

#### VENDOSI:

Në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin Nr.153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:

Neni 292, me titull “Modeli dhe karakteristikat e lejes së drejtimit, (neni 115 i Kodit Rrugor) ndryshon si më poshtë vijon:

(neni 115 i Kodit Rrugor)

1. Modeli i lejes së drejtimit të motomjeteve dhe automjeteve rrugore të prodhohet me parametra, që të respektojnë standardet e vendosura nga Komuniteti Europian.

2. Për të shmangur mundësinë e falsifikimit, leja e drejtimit të përbëhet nga elemente të larta sigurie (vizive dhe të kontrollueshme, nëpërmjet pajisjeve të specializuara).

3. Karakteristikat e lejes së drejtimit përcaktohen në modelin përfundimtar të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili bëhet pjesë përbërëse e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor.

4. Mënyra, procedura e lëshimit të lejes së drejtimit, hollësitë e tjera të nevojshme dhe periudha e vlefshmërisë së modelit të vjetër të lejes së drejtimit ose e bashkëvlefshmërisë së tyre me modelin e ri të lejes së drejtimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko

**UDHËZIM**  
**Datë 27.6.2002**

**PËR “MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KËRKESAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË SHOQËRIVE QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutes, në zbatim të pikës 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.30, datë 28.01.2002 “Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrdhënieve të shoqërive që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, Ministri i Industrisë dhe Energjetikës, Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Mjedisit,

**UDHËZOJNË:**

1. Komisioni fillon funksionimin e tij për shqyrtimin e kërkesave që do të paraqiten nga shoqëritë për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, mbas publikimit që do të bëhet nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës sipas paragrafit a) të pikës 1 të VKM nr.30, datë 28. 1 .2002.

2. Komisioni mblidhet për shqyrtimin e kërkesavejo më vonë se 15 ditë nga data e depozitimit të çdo kërkesë data e mbledhjes caktohet nga kryetari i komisionit dhe njoftimi i anëtarve bëhet jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Në mbledhjen e rradhës se komisionit shqyrtohen të gjitha kërkesat e ardhura 10 ditë para datës së mbledhjes se komisionit.

4. Njesia e trajtimit dhe përpunimit të dokumentacionit për marrjen e lejes së koncesionit për instalimet bregdetare dhe ndjekjen e zbatimit të saj, në sektorin e licensave, sistemon kërkesat me dokumeftacionin përkatës dhe njofton kryetarin dhe antarët e komisionit për çdo kërkesë të depozituar, sipas datës përkatëse.

5. Si elemente bazë për kredibilitetin financiar komisioni do të vlerësojë burimet e financimit dhe gjendjen në llogarinë bankare në momentin kur paraqitet kërkesa.

6. Për rastin kur për të njëjtën sipërfaqe paraqiten më shumë se një kërkesë nga shoqëri të cilat i plotësojnë kërkesat sipas pikës 2 të VKM nr.30. datë 28.01.2002. komisioni bën vleresimin e kërkesës duke marrë ne konsiderate keto kriteret:

- a) Kapaciteti i depozitave që do të instalohen.
- b) Vlera e investimit
- c) Koha që shoqëria parashikon të përfundojë ndërtimin e instalimeve.
- d) Teknologjia që do të përdoret të jetë e re, me kushte dhe norma teknike sipas Urdhërit të Ministrisë nr.182, datë 09.04.2001 si dhe e çertifikuar sipas standarteve të Komunitetit Europian.
- e) Raporti i vlerësimit të Ndikimit në Mjedis V.N.M.

7. Kur mbi bazën e kriterëve të vendosura në pikën 6, komisioni konstaton plotësim të njëjtë kushtesh nga të gjithë shoqëritë që kanë paraqitur kërkesë për të njëjtën sipërfaqe. Si kriter bazë për diferencimin midis shoqërive komisioni do të përdore vlerën e bonusit që do të ofrojë secila shoqëri në dizpozicion të buxhetit të shtetit. Për këtë komisioni njofton shoqëritë për vendin, datën dhe orën në të cilën ata duhet të paraqesin dokumentin bankar që vërteton derdhjen e 1% të vlerës së bonusit të ofruar. Në numrin e Ilogarisë së MIK (4302/1700).

8. Si elemente bazë për dokumentacionin e përvojës në fushën e ndërtimit dhe përdorimit të instalimeve bregdetare komisioni do të vlerësojë dokumentacionin ku pasqyrohet eksperiencia dhe aktiviteti i deritanishëm në këtë fushë i shoqërisë që do të zbatojë projektin, qoftë kjo joint-venture me shoqërinë investitore apo kontraktor i deklaruar nga shoqëria investitore.

9. Mbledhja e komisionit konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë Jo më pak se 3/4 e anëtarëve të tij.

10. Komisioni merr vendim me shumicë të thjeshtë votash dhe kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Anëtarët e komisionit të cilët janë kundër shumicës shprehin qëndrimin e tyre në proces verbalin e mbledhjes.

11. Anëtarët e komisionit nuk mund të përfaqsohen në mbledhje nga persona të tjerë. Në rastet kur për arsye të pashmangshme ndonjë nga anëtarët e komisionit nuk mund ta kryejë këtë funksion komisioni plotësohet me anëtarin e caktuar nga Ministri përkatës.

12. Në mbledhje mbahet proces verbali në të cilën pasqyrohet pjesëmarrja në komision, çështjet që diskutohen, diskutimet e anëtarëve të komisionit, si dhe vendimi që merret.

13. Vendimi i komisionit hartohet nga kryetari konform qëndrimit të shprehur dhe votimit të bërë dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe njofton shoqëritë brenda 5 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimj.

14. Shoqëritë që pajisjen me autorizim, në rast se nuk arrijnë në marrëveshje me pronarët e tokës mbi të cilën do të ndërtojnë insulimet bregdetare, brenda 30 ditëve duhet të njoftojnë në MIE'.(Njesinë e trajtimit dhe përpunimit të dokumentacionit), njëkohësisht të paraqesin kërkesën për shprehim për interes publik. në zbatim të pikës 10. të VKM nr.30. datë 28.1.2002.

15. Në vartësi të vendimit që men komisioni vazhdon praktikën procedurale, sipas pikës 5 të VKM nr. 30 datë 28.1.2002.

16. Anëtarët e komisionit shpërblehen për çdo mbledhje të shqyrtimit të kërkesave në vlerën 5.000 lekë, kurse kryetari 7.000 lekë. Ky shpërblim do të sigurohet nga të ardhurat e Ministrisë së Dustrisë dhe Energjitikës, në mbështetje të VKM nr.424, datë 09.07.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

17. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë botimit në Gazetën Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT  
**Lefter Xhuveli**

**VENDIM**  
**(I shkurtuar)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durës, me vendimin nr.819, datë 23.5.2002, shpall të zhdukur shtetasin Lutfi Jakup Mara, i datëlindjes 5.1.1962 nga data 10.5.1999, banues në Durrës

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.6.2002  
Doli nga shtypi më 27.6.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë